



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 06 DATË 28.02.2022

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË DIMAL PËR PËRFAQËSIMIN E BASHKISË DIMAL SI AKSIONAR NË MBLEDHJET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË AKSIONARE PLATFORMA VIRTUALE "FARM& MARKET SH.A"

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike ,në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 7 pika 2, Neni 8 pika 2, Neni 54 pika k, Neni 55, Neni 140 të Ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar , VKB Nr 56 datë 24.12.2019 "Mbi miratimin e themelimit dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Ura Vajgurore në Shoqërinë Aksionare "Platforma Virtuale Farm & Market Sh.A" dhe miratimin e aktit të themelimit dhe statutit, Këshilli Bashkiak Dimal në cilësinë e Aksionarit të Shoqërisë "Platforma Virtuale Farm & Market "sh.a pasi mori në shqyrtim dhe propozimin e Kryetarit të Bashkisë Dimal

VENDOSI

Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Të Autorizojë Kryetarin e Bashkisë Dimal Znj. Juliana Memaj, të përfaqësojë Bashkinë Dimal, si aksionar të Shoqërisë "Platforma Virtuale Farm & Market" sh.a, në të gjitha mbledhjet që do të zhvillojë Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionare "Platforma Virtuale Farm&Market" "Sh.a.gjatë gjithë periudhës së mandatit të Këshillit Bashkiak Dimal.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Dimal për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Hysen Hoxha



Adresa: Lagjia. "18 Tetori" Rr. "Dimal "
web: Uravajgugore.gov.al

Tel: 036122468

e-mail: Bashkia@bashkiadimal.gov.al

